# DËSHMI ARKIVI

**A-439344**

VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dokumentari për shqiptarët në Venedik, Ilir Yzeiri nderohet me çmim në Festivalin e Venecias |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/dokumentari-per-shqiptaret-ne-venedik-ilir-yzeiri-nderohet-me-cmim-ne-fe-i585749` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 08:33:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 08:32:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `42610a554f899140ca679bcde7b6ed511553fc2fc69594747aadfca5e3f12057` |
| TEKSTI | `90d45b2511bf888f1cc63acf46478bb71f6f12aecd5bde40503be9735455be80` |
| PAMJA | `b5b9df3d07e861109bc4504fd6bb63b2efb2014cfd07d3f28423548d2670aea2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8699082f8b404066e8aaa7748b8cfc5fe75e1e5bda8ce88f9661f65f9d8c4cd7` |
| E MËPARSHMJA | `46f985d6b85116a9fa5fe8c06be26adec27ce3d013770391bfe23998c4ff50b4` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8699082f8b404066e8aaa7748b8cfc5fe75e1e5bda8ce88f9661f65f9d8c4cd7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Dokumentari për shqiptarët në Venedik, Ilir Yzeiri nderohet me çmim në Festivalin e Venecias

13 Shtator 2026, 10:32Kulturë TEMA

Dokumentari për shqiptarët në Venedik, Ilir Yzeiri nderohet me

Qysh një muaj më parë, dokumentari i Ilir Yzeirit- "Lucia Nadin dhe shqiptarët në Venedik 1474-1552" ishte përzgjedhur nga Regione Venetto për të marrë pjesë në Festivalin e 83 ndërkombëtar të Venecias. Ai Festival mbahet në dy salla të veçanta- në atë qëndroren dhe në atë të Hotel Exelcior. Në këtë të dytën paraqiten dokumentarët dhe filmat artistikë që janë përzgjedhur që 1 vit më parë nga një juri ndërkombëtare. Dokumentari i Ilir Yzeirit është marrë nga kompania Cinemaset me qendër në Romë dhe në muajin tetor do të paraqitet në disa platforma ndërkombëtare. Kjo kompani e pataqiti edhe në festivalin e Venecias.

Ky është ndër dokumentarët e pare i realizuar nga një shqiptar që përzgjidhet nga këto platforma.

Në këtë festival ishte po ashtu dhe producenti i njohur dhe një nga intelektualët e biznesmenët më të dalluar në rajonin e Venetos, që jeton e punon në Venecia, Emiliano Biraku. Një film i tiji, ku ishte producent u nderua po ashtu me çmim të parë si dokumentari më i mirë.

Ilir Yzeiri e realizoi dokumentarin e tij në vitin 2024 falë mbështetjes së qeverisë shqiptare dhe interesimit të posaçëm të kryeministrit Rama. Aty, në mënyrë kronologjike tregohet se çfarë ndodhi me shqiptarët kur ra Shkodra. Duke u mbështetur në veprat dhe rrëfimin e Luçia Nadinit dokumentari rindërton edhe njëherë atmosferën që u krijua në Venedik kur erdhën shqiptarët dhe autori ndjek me kamera fatin e Marin Barletit, Beçikemit, etj. Tregohen po ashtu "Shkolla e shqiptarëve", vendet e shenjta, kishat afresket me motive nga qëndresa e Skënderbeut. Përmendet dhe tregohen skulpturat në dru të Kamsit një nga më të mëdhenjtë skulptorë të drurit në Mesjetën veneciane e më gjerë. Lucia Nadin tregon edhe momentin kur zbuloi "Statutet e Shkodrës". Xhirimet në Venecia dhe rrëfimi i Lucies nxjerrin në dritë një kohë kur Shqipëria ishte pjesë integrale e Europës së zhvilluar. Ato gjurmë që në Shqipëri mezi duken, Ilir Yzeiri, që u nderua si regjisori më i mirë i filmit dokumentar në Festivalin e Venecias, i tregon në dokumentarin "Lucia Nadin dhe shqiptarët në Venedik 1478-1552".

## 5 Komente

D Dardan

13 Shtator 2026, 10:41

Urime Profesor Ilir Yzeiri!

Përgjigjjuni

👍 1 👎 0 ❤️ 0

T Tellalli

13 Shtator 2026, 11:47

Urime profesor !

Përgjigjjuni

👍 0 👎 0 ❤️ 0

N Ne tregomë se si ishim!! Se sot jemi jev Andollak

13 Shtator 2026, 11:48

Ne tregomë se si ishim!! Athër ishim shqiptare dhe të Krishtër... Sot shumica jemi Turq-azjatik-jev-Mongolez, shumë të prapambetur barbar...

Përgjigjjuni

👍 2 👎 3 ❤️ 0

---

Aleksander Caka

13 Shtator 2026, 13:48

Urime Profesor Ilir Yzeiri...

Përgjigjjuni

👍 0 👎 0 ❤️ 0

---

Qytetari

13 Shtator 2026, 13:55

Më bëhet qejfi për Z.Yzeiri për suksesin e tij. Më pëlqejnë dhe shkrimet e tij të goditura dhe realiste.

Përgjigjjuni

👍 0 👎 0 ❤️ 0

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Gonxhja: Mbështesni zbulimin arkeologjik në Strikçan për çmimin ndërkombëtar "Palmyra"

08:50 Kulturë

Dokumentari i Gjon Kolndrekajt "Zoja e Këshillit të Mirë" prezantohet Festivalin e Filmit në Venecia

18:14 Kulturë / 1 koment

Teatri "Bylis" fillon sezonin e ri

17:12 Kulturë

Protestë kundër muzeut hebraik në Vlorë/ Rama: Një grup delenxhinjsh me në krye Lesko pijanikun kanë mësyrë sot në kantierin e Muzeut Hebraik të Vlorës

15:48 Kulturë / 17 komente

Dokumentari për Gazën "NAZA" mahnit Venecian

15:10 Kulturë / 1 koment

## Nis sezoni i ri në TKOB

13:07 Kulturë

## Mauzoleumi i zbuluar në Bulqizë, finalist për Çmimin Ndërkombëtar "Palmyra"

11:06 Kulturë

## Rama: Lajm i bukur i rikthimit të Deas së Butrintit në shtëpinë e saj (VIDEO)

09:08 Kulturë / 3 komente

## Rikthehet në Pogradec Festivali i Monodramës "Albamono"

09:04 Kulturë

## Dea e Butrintit kthehet në Shqipëri

21:10 Kulturë / 4 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**Unë jam me Petrit Malajn**

14:45 Blog / 60 komente

**'Det' pjesëmarrësish në 'Marshin për liri' në Prishtinë: ...**

15:15 Rajoni / 74 komente

**BE reagon para vendimit për Thaçin dhe ish-krerët e UÇK-s...**

14:30 Rajoni / 33 komente

**John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?**

11:40 Blog / 21 komente

**VIDEO/ Edi Rama: Karakaçi, ministër i shkëlqyer. Balluku ...**

10:02 Politika / 7 komente

### Blog Tema

**Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor**

16:13 Blog / 4 komente

**Shënime nga Konventa e Teksasit në ShBA**

12:00 Blog / 40 komente

**EuReporter artikull për kryebashkiakun, Veliaj deklaron: "Ende nuk e kam humbur shpresën"**

10:30 Blog / 9 komente

### Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU

Ju mund të c'regjistroheni në çdo moment

[Powered by Tomorrow.io]

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by



Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.